

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
”RENEWABLE ENERGY TECHNOLOGY” SHPK

Sot, më datë 12/10/2023, u paraqit personalisht:

- **Zj. Manjola Aliu, e datëlindjes 09/08/1982, shtetase shqiptar, lindur ne Pogradec dhe banuese ne Tiranë, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtes i kartes se identitetit me Nr. 034377210 dhe Nr. Personal I25809057T.**

I cili përpiloi këtë akt themelimi të shoqërisë tregtare “RENEWABLE ENERGY TECHNOLOGY” SH.P.K, me termat e mëposhtme:

NENI 1

Forma Ligjore

Të themeloj Shoqërinë Tregtare "RENEWABLE ENERGY TECHNOLOGY" SH.P.K, në formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar. Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria drejtuar të tretëve si dhe në të gjitha aktet e brendshme të saj, do të shënohet detyrimisht emri "RENEWABLE ENERGY TECHNOLOGY" SH.P.K, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Akt Themelimi dhe në Statut.

NENI 2

Qëllimi i krijimit të Shoqërisë.

Qëllimi i krijimit të kësaj Shoqërie është zhvillimi i aktivitetit ekonomik në fusha të ndryshme tregtare. Veprimtaria e kësaj Shoqërie do të jetë tërësisht me karakter ekonomik dhe qëllim fitimprurës.

NENI 3

Emri dhe vula e shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin e subjektit "RENEWABLE ENERGY TECHNOLOGY" SH.P.K dhe me emrin tregtar **RENEWABLE ENERGY TECHNOLOGY**. Ajo do të ketë edhe vulën e saj.

NENI 4

Objekti i veprimtarisë

Veprimtaria e shoqërisë do të jetë:

- Prodhimi, transmetimi, shpërndarja dhe shitja e energjisë
- Prodhimi i gazit, shpërndarja e lëndëve të gazta nëpërmjet tubacioneve
- Projektimi, ndërtimi, rehabilitimi dhe fuqizimi i çentraleve për prodhimin e energjisë dhe infrastruktura e impianteve. Kërkimi dhe zhvillimi i impianteve dhe aparaturave për prodhimin e energjisë.



- Asistenca teknike, riparime dhe mirëmbajtja e aparaturave për prodhimin e energjisë. Import – Eksporti, tregtimi me shumicë dhe pakicë i energjisë elektrike, mallrave, materialeve dhe aparaturave që lidhen me kryerjen e aktivitetit në fushën e energjisë.
- Instalimi dhe ndërtimi i impianteve energjitike nga burime të rinovueshme nga dielli, era, uji, etj
- Prodhimi, transmetimi, shpërndarja dhe shitja e energjisë nga burime të rinovueshme
- Importi dhe eksporti i mallrave e pajisjeve të teknologjisë në fushën e energjetikës, që do të përdoren në ndërtimin, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e centraleve me impiante fotovoltaike e forma të tjera të prodhimit të energjisë të ushqyera nga burime të ndryshme dhe nga ato të caktuara si: hidroelektrike, diellore, me erë, biomasa, etj
- Mirëmbajtja e çentaleve energjitike
- Zhvillim të projekteve në sektorin e energjive të rinovueshme, ndërtimin dhe mirëmbajtje të punimeve civile, objekteve të ndryshme, linjave elektrike, kërkim dhe zhvillim të shpellave dhe minierave.

NENI 5

Selia e Shoqërisë dhe Afati

Selia e Shoqërisë ndodhet në Tiranë, në adresën: Njësia Bashkiake Nr.10, Rruga e Kavajës, Godina Nr.97, Tiranë.

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një periudhë kohore pa afat.

NENI 6

Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar është Lekë 100.000 (njqind mije leke) dhe zotërohet nga ortakët themelues:

Vlera totale e kapitalit të regjistruar: Lekë 100.000 (njqind mije leke)

Vlera e paguar: 100.000 leke

Numri total i kuotave: 1.

Kapitali themeltar është mbuluar tërësisht nga ortakët themelues.

NENI 7

Ortakët themelues i Shoqërisë Tregtare "RENEWABLE ENERGY TECHNOLOGY" SH.P.K zotëron kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

Ortakët themelues :	Manjola Aliu
Numri i kuotave :	1
Numri i pjeseve :	1
Pjesëmarrja në Shoqëri :	100,00 %
Lloji i kontributit:	Ne para
Vlera e kontributit	100,000 (njqind mije) leke

Duke qene se Kapitali themeltar do te depozitohet ne llogarine e Shoqerise e cila do te hapet pas rregjistrimit ne QKB, atehere ortaku vendos qe kjo shume do te paguhet prej tij jo me vone 3 muaj nga data e regjistrimit te shoqerise ne QKB, ne llogarine e shoqerise tregtare.
Rregullat e pageses se kesaj shume jane parashikuar ne kete Statut.

NENI 8

Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratori/ët – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

NENI 9

Administratori/ët

Shoqëria administrohet nga ana e Administratorit i cili zgjidhet për një mandat 5 (pese) vjeçar me të drejtë rizgjedhje. Administratori i shoqerise do te jetë :

- **Zj. Manjola Aliu, e datëlindjes 09/08/1982, shtetase shqiptar, lindur ne Pogradec dhe banuese ne Tiranë, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtes i kartes se identitetit me Nr. 034377210 dhe Nr. Personal I25809057T.**

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administrator/ët, duke i ushtruar këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 10

Oratku/ Ortakët mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 11

Ortaku/Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre.

NENI 12

Mosmarrveshjet për themelimin e Shoqërisë zgjidhen me mirekuptim dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata kompetente.

NENI 13



Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortaku Themelues, u gjet sipas vullnetit të tij dhe u nënshkrua pa vërejtje. Akti i Themelimit hartohet në gjuhën shqipe, duke qene se ortaku eshte njohes i gjuhes shqipe.

ORTAKU THEMELUES

Manjola Aliu

Manjola Aliu

